



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	15-11-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHCK	7147/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.877/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.877/2022 të datës 07.10.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ përmes Postes së Kosovës me numër R24232028, me adresë _____ në Komunë të Mitrovicë, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET e bazuar ankesa me numër A.nr.877/2022 e datës 07.10.2022 e parashtruar nga ankuesi _____
- II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil _____ nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sipas Akt emërimit të datës 26.11.2013 në pozitë të "Inspektorit të Ndërtimit" me datë 07.10.2022 ka parashtruar ankesë përmes Postës së Kosovës me numër R24232028, në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar në këshill me numër A.nr.877/2022 dhe numër protokollit 5961/2022, me pretendimet për harmonizim të koeficientit me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 01.11.2022 përmes postes elektronike E-mailit, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5961/2022 të datës 07.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër reference: 01.120/04-0087265-2/22 e datës 26.09.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore; Konkursi i datës 23.09.2022; Pliko/zarfa postës së Kosovës e datës 07.10.2022 e Postës së Kosovës me numër R24232028; E-mail-Përgjigje në ankesë e datës 01.11.2022; Akt emërimi i datës 14.08.2012 e z.M.V; Përshkrimi i detyrave të punës "*Inspektor i ndërtimit*" i datës 24.09.2012; Kërkesë e datës 22.09.2022 me numër 01-120/04-0087266/22; Akt emërimi i datës 26.11.2013 e ankuesit Kërkesë e datës 22.09.2022 me numër 01-120/04-0087267/22 nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e **bazuar, SEPSE:**

Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës për pozitën "*Inspektor i Ndërtimit*", Kolegji ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "*Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*", si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: "*Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë*". Andaj mbi këtë bazë ligjore e nisur nga konstatimi si më lartë se ankuesi është emëruar në pozitën "*Inspektor i Ndërtimit*", me koeficient gjashtë(6) të pagës, si dhe duke u bazuar në një shkresë të datës 26.09.2022 në lidhje me ankues tjerë të të njëjtit nivel, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilin është konfirmuar se pozita inspektor-klasa profesionale 1, ka të përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor si më lartë, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur se Komuna e Mitrovicës së Jugut bazuar në kërkesën e ankuesit të datës 23.09.2022 lidhur me harmonizimin e koeficientit prej gjashtë (6) në tetë (8), të njëjtën e ka refuzuar me datë 26.09.2022 përkundër pranimit të shkresës zyrtare përmes e-mailit zyrtar të datës 26.09.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se pozita e *Inspektorit-në kategorinë profesionale 1 duhet të jetë me koeficient të pagës tetë (8)*, kështu që mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë se mos harmonizimi-zbatimi i



koeficienteve të ndryshëm të pagës për pozitë të njëjtë të punës sipas Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, nuk është në harmoni me dispozitat e nenit 2 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi si dhe nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin parashihet se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë...”*, kështu që Kolegji vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit sa i përket harmonizimit të koeficientit të pagës me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.877/2022, datë 15/11/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.